



01/Nr.3368 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 17 shkronja (r), 40.2, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 neni 2.3, Statutin e Komunës neni 74 shkronja (k). Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017 merr:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “JAVËN KULTURORE” 2017

#### I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për “Javën Kulturore” 2017 në Komunën e Hanit të Elezit.

#### II

Duke ju referuar nenit -I- të këtij vendimi i cila i dedikohet “Javës Kulturore” 2017, mjetet financiare do të merren nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime nga Drejtoria e Arsimit dhe Zyra e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare për mbështetje të “Javës Kulturore” 2017 është 6,652.75 €.

#### III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

#### IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

#### V

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.05.2017



Kryesuesi i Kuvendit  
Qamush Brava



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3208 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017 merr:

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE**

**I**

Kuvendi i komunës miratoj vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për kompaninë "Afa Energy" shpk sipas kërkesës së parashtruar nga kompania.

**II**

Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 500 m<sup>2</sup>, dhe gjendet në parcelën kadastrale Nr.00183-0 në vendin e quajtur "Kareviq" zona kadastrale Pustenik, më kulturë kullos e klasit të pestë (5), e evidentuar në emër të PSH EKONOMIA E PYJEVE , sipas certifikatës pronësore P-73317070-00183-0.

**III**

Kompania "Afa Energy" shpk në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtimi i objektit të Hidrocentralit) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

**IV**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

**V**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**VI**

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.05.2017



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Qamush Brava**



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3549 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 shkronja (g), 11, 40, Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027 neni 37, Rregulloren Nr.28/2012 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Statuti i Komunës neni 77. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017 merr:

**V E N D I M**

PËR PLANIN E VLERËSIMIT TË RREZIKUT NGA FATKEQËSIT NATYRORE DHE FATKEQËSIT TJERA PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

**I**

Kuvendi i komunës miratoj vendimin për planin e vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Hanit të Elezit.

**II**

Plani i vlerësimit të rrezikut i përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi përmban gjithsejtë 72 (shtatëdhjetë e dy) faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**III**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe mekanizmat tjerë relevantë.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**V**

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.05.2017





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 4027 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, Statuti i Komunës neni 35.1, 41, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017 merr:

**V E N D I M**

PËR PLOTËSIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

**I**

Kuvendi i komunës miratoj vendimin për plotësimin e përbërjes së komitetit për politik dhe financa.

**II**

Duke ju referuar pikës I të këtij vendimi z.Florim Shkreta emërohet anëtarë i komitetit për politik dhe financa nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës-PDK" duke e zëvendësuar anëtarin z.Bujar Ballazhi.

**III**

Ndryshimi i përbërjes së komitetit për politik dhe financa bëhet duke u bazuar në vendimin e komisionit zgjedhorë Nr.386-2017 të datës 26.04.2017.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**V**

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 25.05.2017



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Qamush Brava**



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 3578 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40.2 , Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr.05/L-125 për vitin 2017 neni 1 pikat 1.29, 1.30, neni 16, 17, 18, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48 neni 30, Instruksioni mbi rishikimin e buxhetit nga Ministria e Financave me numër 01/1568 të datës 08.05.2017, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 25.05.2017 merr:

**V E N D I M**  
**PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2017**

**I**

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2017 për kategoritë ekonomike të shpenzimeve.

**II**

Rishikimi i mjeteve në total është në shumë prej **186,783.20 €**, ku rialokimet dhe transferet janë në kategoritë ekonomike si vijon: Paga dhe mëditje në shumë prej 3,660.00 €, mallra dhe shërbime në shumë prej 13,457.20 €, shpenzime komunale në shumë prej 302.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 6,000.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 161,908.00 €.

**III**

Në kuadër të kategorisë paga dhe mëditje transferet janë në shumë prej 3,660.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike mallra dhe shërbime rialokimet janë në shumë prej 13,176.20 €, transferet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në ato shpenzime komunale janë në shumë prej 281.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime komunale rialokimi i mjeteve është në shumë prej 302.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike subvencione dhe transfere rialokimi i mjeteve është në shumë prej 6,000.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale rialokimet janë në shumë prej 103,928.00 €, kurse transferet janë në shume prej 57,980.00 €.

**IV**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

V

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave - Departamenti i Buxheteve Komunale dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 25.05.2017



Kryesuesi i Kuvendit  
Qamush Brava